



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 2/508

Datë: 12/9/2017

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" bazuar në propozimin e Këshillit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, përkatësisht nenit 87, pika 2 dhe 3, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më,07.9.2017, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për Studime master në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës, "Hasan Prishtina".
- II. Pjesë përbërës e këtij vendimi do të jetë edhe Rregullorja për Studime master në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shfuqizohen vendimi me nr. 2/46 dt:11.7.2017.

### A r s y e t i m

Duke pasur parasysh domosdoshmërinë për hartimin e një Rregullore e cila përcakton kriteret unike për organizimin dhe llojet e studimeve bachelor, kushtet e regjistrimit në studime bachelor, shkollimin e të rinjve në fushën e Edukimit Fizik dhe Sportit, në nivelet e arsimit të lartë, me qëllim që të jenë në gjendje t'i përgjigjen kërkesave të tregut të punës në vend e më gjerë, t'i përshtaten edukimit të vazhdueshëm në këtë fushë shumë dinamike, si dhe të kontribuojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm teknologjik, social dhe shkencor të Kosovës dhe më gjerë, si dhe çështjet tjera të rëndësishme për studimet bachelor në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, prandaj mbi këtë bazë, Senati i UP-së, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Vendimi t'i dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së
2. Komisionit të Studimeve;
3. Dekanatit të FEFS-së;
4. Sekretarit të Përgjithshëm të UP;
5. Zyrtarit Ligjor të UP-së.



Senati i Universitetit të Prishtinës

Prof. dr. Marjan Dema -Kryesues



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/508

Datë: 12/9/2017

Në mbështetje të nenit 48 paragrafi 1.9, nenit 109 paragrafit 3, të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina, dhe me propozimin e Këshillit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, bazuar në nenin 87, pika 2 dhe 3, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e datës, 07.9.2017 miraton:

## RREGULLORE PËR STUDIME MASTER

### Dispozitat e përgjithshme

#### Neni 1

Me Rregulloren për studimet master (në tekstin e mëtejme "Rregullore") përcaktohet mënyra e organizimit të studimeve master dhe Ilojet e këtyre studimeve, kushtet e regjistrimit dhe vijimit të studimeve, provimet dhe suksesi në provime, punimi i diplomës master si dhe përfundimi i studimeve.

### Organizimi dhe Ilojet e studimeve

#### Neni 2

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, i Universitetit të Prishtinës (në tekstin e mëtejme "Fakulteti" ose "Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit") organizon studime të rregullta master për fitimin e gradës akademike në lëmitë e përcaktuara me planin dhe programin mësimor të akredituar të studimeve master.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit mund të organizojë studimet master edhe në bashkëpunim me fakultetet e tjera të Universiteteve jashtë vendit, mbi bazën e programeve të përbashkëta të studimeve dhe memorandumeve për partneritet.

### Neni 3

1. Studimet master kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë studentët të cilët i kanë kryer studimet themelore (bachelor) dhe kanë fituar së paku 180(nga programi 3 vjeçar) dhe 240 kredi (ECT S) nga programi 4 vjeçar, në fushën e Edukimit Fizik dhe Sportit, dhe nëse i plotësojnë kriteret e parapara me konkurs të shpallur nga Universiteti.

2. Në studimet master kanë të drejtë të regjistrohen edhe kandidatët të cilët studimet themelore në fushën e Sportit i kanë kryer jashtë vendit e të cilat njihen nga EUA (Shoqata e Universiteteve Evropiane) ose institucioni i cili është pranuar nga një agjensi ndërkombetare e akreditimit.

3. Barasvlerën dhe nostrifikimin (njohjen) e certifikatave apo të diplomave të fituara jashtë vendit e bën Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bazë të ligjit dhe rregulloreve përkatëse.

### Neni 4

1. Të drejtën e mësimdhënies në studimet master e ka personeli mësimor në thirrje të profesorit (profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent) i cili i plotëson kushtet e parapara me Statutin e Universitetit të Prishtinës.

2. Të drejtën e mbajtjes së ushtrimeve ose seminareve në studimet master e kanë edhe asistentët të cilët i plotësojnë kriteret e Statutit të UP-së.

3. Në raste të caktuara në një lëndë mësimore mund të mbajnë ligjërata dy ose më shumë mësimdhënës.

### Neni 5

1. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit organizon studime master në këto drejtime-programe:

a). Edukim Fizi dhe Sport, (program 2 vjeçar)

b). Master Profesional për trajner (SPEED), (program 1 vjeçar)

### Neni 6

1. Studimet master i udhëheq Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit përmes Katedrave përkatëse. Secila katedër mund të udhëheq një (1) ose më shumë drejtime-programe studimore në nivelin Master.

2. Në kuadër të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, funksionojnë:

a). Katedra e Edukimit Fizik dhe Sportit

b). Katedra e Shkencave Sportive (SPEED) dhe

c). Instituti për Hulumtime Shkencore



3. Listën e mësimdhënësve të propozuar nga Katedra për realizimin e programit në studime master e aprovon Këshilli i Fakultetit.

#### **Neni 7**

1. Mësimi realizohet në formë të ligjëratave mesimit praktike, seminareve, ushtrimeve teorike, punës praktike dhe punës në terren, vizitave profesionale dhe shkencore mësimore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmjet punimeve të pavaruara të studentëve, si dhe punimit përfundimtar (diplomës) për arritjen e titullit master.

2. Mësimdhënësit janë të obliguar që në fillim të vitit të ri akademik t'i njoftojnë studentët me syllabuset e lëndëve si dhe tu sigurojnë së paku dy termine për konsultime me kohëzgjatje prej 1 ore.

3. Oraret e konsultimeve duhet të shpallen në derën e kabinetit të mësimdhënësit.

4. Mësimdhënësit janë të obliguar të mbajnë mësimin sipas dispozitave të Statutit, rregulloreve të veçanta dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

#### **Kushtet e regjistrimit në studime**

#### **Neni 8**

1. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit regjistron studentë sipas kapaciteteve të veta akademike dhe tenike, duke marrë parasysh edhe kërkesat e tregut të punës. Propozimin për regjistrimin e studentëve të rinjë e jep katedra përkatëse dhe e miraton Këshilli i Fakultetit.

2. Vendimin përfundimtar për numrin e studentëve të rinjë për pranim në vitin e parë e merr Senati dhe shpall konkursin për pranim.

#### **Neni 9**

1. Përzgjedhjen e kandidatëve sipas nenit 3 të kësaj Rregullorje e bën Komisioni përkatës me më së paku tre (3) anëtarë, të propozuara nga Dekani dhe miratuar nga Këshilli i Fakultetit.

2. Komisioni duhet të jetë kompetent dhe profesional sipas lëmisë së studimeve.

3. Komisioni, në bashkëpunim me Dekanatin e Fakultetit, e shpall ranglistën e kandidatëve që kanë aplikuar.

4. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në studimet master mund të ushtrojnë ankesë me shkrim në Dekanat brenda dy (2) ditëve të punës pas publikimit të rezultateve. Vendimet për kërkesat e ushtruara merren nga Komisioni i Ankesave në afatin prej dy (2) ditë pune pas ushtrimit të ankesës.



5. Komisioni i ankesave i përbërë nga së paku tre (3) anëtarë propozohet nga Dekani dhe miratohet nga Këshilli i Fakultetit.

#### **Neni 10**

Regjistrimi i studentëve në semestrin e parë në studimet master bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit.

#### **Neni 11**

1. Me rastin e konkurimit kandidatët duhet të sjellin dokumentacionin e paraparë në konkursin e shpallur nga Universiteti.

2. Dokumentet e dorëzuara nga studenti me rastin e regjistrimit mbeten tek zyra e shërbimit të studentëve.

3. Shërbimi i studentëve e bën regjistrimin e studentëve të rinjë në librin amzë, në programin e veçantë për menaxhim me studentë si dhe krijon dosjen e studentit në kopje fizike.

#### **Ndërrimi i programit — drejtimit të studimeve**

#### **Neni 12**

Ndërrimi i programit të studimit bëhet në përputhje me nenet 142-144 të Statutit të Universitetit.

#### **Kohëzgjatja e studimeve**

#### **Neni 13**

Studimet master, (Programi 1 vjeçar), zgjasin një (1) vit akademik, respektivisht dy (2) semestra. Në çdo semestër, me dhënien e provimeve fitohen nga 30 ECTS, respektivisht për përfundimin e këtyre studimeve duhet të arrihen 60 kredi të ECTS

2. Studimet master, (Programi 2 vjeçar), zgjasin dy (2) vite akademike, respektivisht katër (4) semestra. Në çdo semestër, me dhënien e provimeve fitohen nga 30 ECTS, respektivisht për përfundimin e këtyre studimeve duhet të arrihen 120 kredi të ECTS.

3. Studenti, sipas kushteve të përcaktuara në Statutin e Universitetit, përfundon studimet dhe mbron temën e masterit brenda afatit prej maksimum dy (2) viteve të programi një (1) vjeçar, ndërsa katër (4) vite të programi dy (2) vjeçar. Me kërkesë të veçantë nga ana e studentit, studentit mund t'i lejohet edhe një vit shtesë për përfundimin me sukses të provimeve të mbetura dhe temës së masterit. Vendimin e merr Këshilli i Fakultetit në pajtim me dispozitat e Statutit.

4. Studentit i përfundon statusi i rregullt në mënyrë automatike kur dështon të kalojë me sukses të gjitha provimet e parapara dhe temën e masterit në programin ku është i regjistruar në afatin dy vjeçar të Programi një vjeçar, respektivisht në afatin katër vjeçar të Programi dy vjeçar, në rastin

kur nuk i është aprovuar kërkesa për lejueshmëri të vazhimit të afatit edhe për një vit si në paragrafin paraprak, ose kur dështon të kaloj të gjitha provimet e parapara dhe temën e masterit, në programin ku është i regjistruar në afatin prej tre viteve nga dita e fillimit të studimit në atë program-(Te programi një vjeçar), Respektivisht pesë(5) viteve nga dita e fillimit të studimit në atë program-(Te programidy vjeçar).

5. Fillimi dhe mbarimi i semestrave mësimor bëhet sipas dispozitave të Statutit të Universitetit të Prishtinës. Mësimi në studimet master zhvillohet në pesëmbëdhjetë (15) javë për një semestër.

### **Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit**

#### **Neni 14**

1. Kandidati i regjistruar në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit e ka statusin e studentit të rregullt.
2. Statusi i studentit dëshmohet me ID ose me ndonjë dokument të barasvlershëm.
3. Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit janë të rregulluara me Statutin e Universitetit të Prishtinës.
4. Këshilli i Fakultetit i përjashton nga Fakulteti përkohësisht ose përgjithmonë studentët të cilët i shkelin rregullat e përcaktuara me Rregulloren për procedurën disiplinore të Universitetit të Prishtinës.
5. Humbja e statusit të studentit rregullohet me nenin 150 të Statutit të Universitetit të Prishtinës.

### **Të drejtat dhe obligimet e studentëve**

#### **Neni 15**

1. Të drejtat dhe obligimet e studentëve që janë përcaktuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës vlejné edhe për studentët e studimeve master në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe i Sportit.

#### **Neni 16**

1. Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore të studentëve rregullohet me Rregulloren për Procedurën Disiplinore të Universitetit të Prishtinës.

#### **Neni 17**

1. Studentët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Komisionin e Ankesave të Fakultetit kundër vendimit të shqiptuar nga organet e Fakultetit që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

2. Ankesat e tilla i dorëzohen Komisionit të studimeve të Fakultetit brenda 8 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.
3. Komisioni i studimeve është i obliguar t' ia dorëzojë raportin për vendimin e shqiptuar Këshillit të Fakultetit brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.
4. Ankesa rreth vendimit të shkallës së parë vendoset nga Senati i Universitetit.

### **Vazhdimi i regjistrimit të vitit**

#### **Neni 18**

1. Për të mbajtur statusin e studentit aktiv me të drejtat e plota, studentët të cilat nuk kanë arritur t'i përfundojnë me sukses të gjitha provimet brenda vitit të rregullt akademik, duhet të vazhdojnë regjistrimin e vitit tek zyra e shërbimit për studentë.
2. Senati i Universitetit të Prishtinës me vendim të veçantë përcakton kushtet e vazhimit të regjistrimit të vitit.

### **Provimet dhe suksemi në provime**

#### **Neni 19**

1. Studentët janë të obliguar të paraqesin provimet në afatin e paraparë nga fakulteti. Provimet organizohen nga të gjitha lëndët e parapara me planin e studimeve, pas përfundimit të mësimit të lëndës përkatëse. Studenti fiton të drejtën t'i nënshtrohet provimit nga një lëndë pasi t'i kryej obligimet që parashihen me programin mësimor.
2. Provimet që përmbajnë pjesë praktike mbahen me shkrim dhe me gojë. Studenti mund t' i nënshtrohet provimit në mënyrë gojore, vetëm atëherë kur në pjesën me shkrim ka marrë notën pozitive.
3. Për përcaktimin e suksesit akademik të studentit, mund të aplikohen edhe këto forma pune: Kolokviumi, punimi seminarik, punimi kërkimor, testi dhe ushtrimet praktike.
4. Këshilli i Fakultetit mund të marr vendim me qëllim të standardizimit të përpilimit të testeve dhe menyrës së vlerësimit për provimet që organizohen në formë të shkruar.

#### **Neni 20**

1. Provimet në studimet master mbahen gjatë vitit akademik sipas afateve të përcaktuara me Statut dhe me vendime të Senatit të Universitetit të Prishtinës.

#### **Neni 21**



1. Suksesi i studentit në provim shprehet me nota 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë). Vlerësimi i arritshmërisë shprehet në përqindje në raport maksimumin e kërkuar për kalueshmërinë e lëndës përkatëse dhe vlerësohet sipas formulës si më poshtë:

51% - 60% = 6 (gjashtë);

61%- 70%=7 (shtatë);

71%-80% = 8 (tetë);

81% - 90% = 9 (nëntë); dhe

Mbi 90% = 10 (dhjetë).

2. Evidentimi i suksesit të studentëve bëhet në mënyrë elektronike në SEMS sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren për SEMS.

3. Fletëparaqitjet dhe procesverbali i provimit i dërgohen referentit i cili më së voni 2 ditë pas kryerjes së provimit e regjistron në kompjuter, në librin amzë dhe në dosjen e studentit.

4. Afatet e provimit janë publike dhe shpallen në tabelën e shpalljeve të drejtimeve përkatëse si dhe në faqen zyrtare të fakultetit në internet.

5. Shpallja e rezultateve të provimit përkatës bëhet përmes SEMS-it, së bashku me njoftimin për kohën dhe vendin e mbajtjes së konsultimeve. Konsultimet duhet të mbahen brenda 24 orëve pas evidentimit të notave në SEMS.

## **Neni 22**

1. Për studentët të cilët nuk janë të kënaqur me vlerësimin dhe notën e marrë në provim, vlejné dispozitat e Statutit të UP-së.

## **Punimi i diplomës së masterit dhe metodologjia e hartimit**

### **Neni 23**

1. Studimet master në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, përfundojnë me punimin dhe mbrojtjen e diplomës së masterit në pajtim me programin e studimeve.

2. Studenti i cili i ka kryer obligimet e parapara me plani-programin mësimor përkatës, fiton të drejtën të marr temën e diplomës për master.

#### **Neni 24**

1. Këshilli i Fakultetit me vendim të veçantë vendos për numrin e temave të diplomës së masterit për të cilat një mësues mund të jetë mentor gjatë një viti akademik.
2. Studentët, në marrëveshje me mentorin e lëndës, propozojnë titullin e temës të diplomës të masterit.

#### **Neni 25**

1. Punimi i diplomës së masterit paraqet punim të pavarur shkencor të kandidatit me të cilin ai/ajo tregon që ka përvetësuar njohuri të nevojshme profesionale dhe metoda të përshtatshme të kërkimit për çështjet profesionale shkencore të fushës përkatëse, nën mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të mentorit.
2. Studenti do të nënshkruaj një deklaratë të etikës profesionale shkencore me të cilën deklaron se punimi i tij është origjinal dhe në kuadër të dispozitave ligjore në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare kundër plagjiaturës.

#### **Neni 26**

1. Propozimi me shkrim për lejimin e temës së diplomës së masterit duhet të përmbajë: titullin me arsyetimin e temës së propozuar, qëllimin shkencor të punimit, hipotezat themelore që do të merren për bazë, metodat që do të zbatohen realizimin e hulumtimit dhe një kornizë të përgjithshme të burimeve të cilat do të përdoren në shtjellimin e temës.
2. Propozimi i drejtohet katedrës përkatëse përmes administratës së nivelit master.
3. Formulari i caktuar i kërkesës mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e fakultetit në internet.

#### **Neni 27**

1. Metodologjia e hartimit të temës së masterit do të përcaktohet me një udhëzues të veçantë i cili do të miratohet nga Këshilli i Fakultetit.

#### **Neni 28**

1. Këshilli i Fakultetit, me propozim me shkrim të Katedrës përkatëse të studimeve master, miraton titullin e propozuar dhe lejon punimin e diplomës për master. Me këtë rast, Këshilli emëron mentorin i cili e udhëheq studentin gjatë punës në temën e punimit të diplomës për master, si dhe dy (2) anëtarët e tjerë të komisionit, njëri prej të cilëve caktohet të shërbejë si kryetar i komisionit.

## **Afati i përfundimit të punimit të diplomës së masterit**

### **Neni 29**

1. Kandidati, në afat prej më së shumti një (1) viti pas vërtetimit të semestrit të dytë të studimeve master (Te programi një (1) vjeçar), respektivisht një (1) viti pas vërtetimit të semestrit të katërt të studimeve master (Te programi dy (2) vjeçar), duhet të dorëzojë punimin e përfunduar me shkrim të diplomës për vlerësim. Kandidati, gjithashtu, duhet të dorëzojë punimin e tij në formë elektronike në njërin nga adresat elektronike zyrtare të anëtarëve të komisionit.
2. Me kërkesë të kandidatit, Këshilli i Fakultetit mund të caktojë një afat shtesë prej më së shumti deri në gjashtë (6) muaj për të dorëzuar punimin e diplomës së masterit. Arsyet për shtyerjen e afatit i vlerëson Këshilli i Fakultetit, pas propozimit të katedrës përkatëse.
3. Në qoftë se kandidati nuk e dorëzon punimin e përfunduar të diplomës së masterit për vlerësim në afatin e caktuar me këtë nen, kandidati duhet ta rifillojë procedurën për lejimin e punimit të diplomës me temë të re.

## **Vlerësimi i punimit të diplomës së masterit**

### **Neni 30**

1. Komisioni për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës së masterit përbëhet prej tre (3) anëtarëve.
2. Nëse mentori ose ndonjëri prej anëtarëve të Komisionit heq dorë nga funksioni i tij në një rast konkret, ai/ajo duhet të japë një arsyetim me shkrim për arsyet e dorëheqjes.
3. Komisioni në kuadër të ushtrimit të kompetencave, vendimet i merr me shumicë votash.
4. Në lidhje me hartimin e një teme specifike të diplomës së masterit, komisioni mund të:
  - a). Miratojë punimin e dorëzuar me shkrim dhe të aprovojë mbrojtjen e punimit;
  - b). Jep komente mbi punimin në tërësi apo pjesë të caktuara duke kërkuar përmirësimin e tyre; ose
  - c). Refuzojë punimin në mungesë të arritshmërisë së pritur në aspektin shkencor apo se punimi nuk reflekton projekt-propozimin fillestar të temës vështruar në aspektin e përgjithshëm të hipotezave të parashtruara me rastin e dorëzimit të kërkesës për punimin e diplomës master, apo nëse punimi është plagjiaturë.
5. Komisioni për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës së masterit harton raportin përfundimtar me të cilin vlerësohet tema e kandidatit, në të cilin vendos për ndonjërin nga opsionet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni.



### **Neni 31**

1. Në qoftë se punimi i kandidatit refuzohet nga komisioni vlerësues ose kandidati për shkaqe të tjera nuk e bën plotësimin e punimit në afatin sipas nenit paraprak, kandidati ka të drejtë që të paraqet kërkesën me shkrim për titullin e ri të punimit të masterit. Këtë mundësi kandidati mund ta shfrytëzojë vetëm një herë, brenda afatit gjashtë (6) mujor.
2. Përjashtimisht pika 1 e këtij neni nuk mund të aplikohet për kandidatin për të cilin Komisioni vlerësues ose ndonjë organ tjetër i Fakultetit ka konstatuar plagjiat.

### **Mbrojtja e punimit të diplomës së masterit**

#### **Neni 32**

1. Mentori në bashkëpunim me kandidatin e përcaktojnë datën, kohën dhe vendin e mbrojtjes së punimit dhe e njofton zyrtarin administrativ përgjegjës të studimeve master.
2. Administrata e studimeve master obligohet që të njoftojë anëtarët e komisionit në mënyrë elektronike në lidhje me datën, kohën dhe vendin e mbrojtjes së punimit nga kandidati konkret, të paktën 5 ditë para axhendës së mbrojtjes së planifikuar.

#### **Neni 33**

Administrata e studimeve master e bënë lajmërimin për mbrojtjen e punimit të masterit shtatë (7) ditë para ditës së mbrojtjes. Lajmërimi shpallet në tabelën e shpalljeve të Fakultetit, dhe në uebfaqen zyrtare të Fakultetit. Në lajmërim jepen të dhënat për kandidatin, temën e punimit dhe detajet tjera të mbrojtjes.

### **Procedura e mbrojtjes së punimit të diplomës së masterit**

#### **Neni 34**

1. Kryetari i komisionit e hap seancën për mbrojtjen publike të punimit të masterit, paraqet të dhënat lidhur me procedurën e zhvilluar deri në nxjerrjen e vendimit mbi lejimin e mbrojtjes të punimit, si dhe paraqet të dhënat biografike të kandidatit.
2. Mentori në pika të shkurtëra e paraqet raportin të komisionit për vlerësimin e punimit të masterit.
3. Kandidati bën një prezantim-paraqitje të përmbledhur të punimit, por jo më gjatë se 20 minuta. Anëtarët e komisionit përmes pyetjeve që ia shtrojnë kandidatit dhe përgjigjeve të tij, e bëjnë vlerësimin e prezentimit të punimit dhe nivelin e njohjes së problematikës që trajton punimi.

### **Neni 35**

1 .Kryetari i komisionit e bën përfundimin e mbrojtjes dhe fton komisionin që të mblidhet për të bërë vlerësimin dhe marrjen vendimin përfundimtar për mbrojtje publike.Vendimi i komisionit shpallet publikisht para kandidatit dhe pjesëmarrësve.

### **Vlerësimi i punimit të diplomës së masterit**

### **Neni 36**

1 .Kandidati ka mbrojtur punimin e masterit nëse shumica e anëtarëve të komisionit kanë dhënë vlerësimin pozitiv për mbrojtjen e punimit.

2. Punimi i mbrojtjes vlerësohet me nota si në vijim:

10 dhe 9 (shkëlqyeshëm)

8 (shumë mirë)

7 (mirë)

6 (mjaftueshëm)

5 (pamjaftueshëm)

3. Kandidati kalon provimin me sukses me notat 6-10.

4. Nota e punimit master nuk llogaritet në notën mesatare të studimeve të këtij niveli.

5. Gjatë vlerësimit të punimit dhe mbrojtjes, duke marrë parasysh prezentimin e kandidatit dhe përgjigjet në pyetjet e parashtruara, Komisioni mund t'a shtyj mbrojtjen për një datë tjetër por jo më shumë se dy (2) muaj, me qëllim që kandidati të jetë i përgaditur për mbrojtje.

6. Nëse kandidati nuk e ka mbrojtur me sukses punimin e masterit, ai mund të paraqet propozim të ri të punimit të masterit brenda gjashtë (6) muajve, prej ditës së njoftimit që nuk e ka mbrojtur publikisht punimin e masterit.

7. Nëse kandidati dështon edhe në mbrojtjen e temës së re atëherë studenti e humb statusin e studentit për këto studime.

### **Fitimi i thirrjes akademike**

### **Neni 37**

1. Pas përfundimit të studimeve dhe mbrojtjes me sukses të tezës së masterit, kandidati fiton thirrjen akademike master i fushës përkatëse (sipas programit të akredituar).

2. Pas fitimit të thirrjes akademike master, kandidati nga shërbimet përkatëse të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit dhe Universitetit të Prishtinës merr certifikatën e nënshkruar nga dekani dhe diplomën e nënshkruar nga dekani dhe rektori.

3. Fakulteti dhe Universiteti mbajnë evidencën e studentëve të diplomuar në studimet master.

#### **Neni 38**

1. Kandidatit thirrja e masterit mund t'i kontestohet dhe t'i mirret nëse konstatohet se punimi i masterit është plagjiat ose është ndonjë falsifikim, sipas standardeve të përcaktuara nga Universiteti.

2. Në rast të dyshimit të bazuar, Këshilli i Fakultetit e formon komisionin prej tre anëtarëve që të shqyrtoj dyshimet e paraqitura lidhur me punimin e masterit.

3. Këshilli i Fakultetit e shqyrton raportin e komisionit dhe nëse konstaton dyshimet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, i propozon Senatit të UP-se marrjen e thirrjes së masterit. Senati i Universitetit të Prishtinës e merr vendimin përfundimtar për marrjen e thirrjes së masterit.

#### **Publikimi i temave të masterit**

#### **Neni 39**

1. Me qëllim të rritjes së transparencës dhe cilësisë së punimeve të diplomës në studimet master, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit publikon në ueb faqen e vet në internet, temën e masterit e cila është miratuar nga komisioni për vlerësimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës së masterit sipas nenit 30, Paragrafi 4, pika a) të kësaj rregulloreje.

2. Publikimi i temës së masterit pas vlerësimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, të publikohet, së paku 7 ditë para mbrojtjes.

3. Tema e masterit do të publikohet duke përfshirë edhe formën elektronike, jo më larg se 30 ditë nga dita e mbrojtjes së temës.

4. Temat e masterit do të qëndrojnë të publikuara në ueb faqen e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit për të paktën 3 vjet nga data e mbrojtjes së tyre publike.


#### **Dispozitat kalimtare**

#### **Neni 40**

1. Kjo Rregullore, me propozimin e Këshillit të Fakultetit, miratohet nga Senati i Universitetit të Prishtinës. Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Ligjit për Arsimin e Lartë të Kosovës.



2. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Univeritetit të Prishtinës.
3. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje mund të bëhen sipas procedurës me të cilën është miratuar.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e më parshme.
5. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shpallet në faqen zyrtare të fakultetit në internet edhe Manuali për hartimin teknik të punimit Master.



Prof. Dr. Marjan Dema

*Marjan Dema*  
Kryesues i Senatit, Rektor